

URDHËR
Nr. 65, datë 20.12.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe të udhëzimit nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit, për blerjet me vlera të vogla apo direkte, te drejtori i Drejtorisë Juridike, znj. Alisa Basha.
2. Kompetenca e deleguar, sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri më datë 31.1.2024.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë Juridike, znj. Alisa Basha.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka